



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel zu Žalbe i Predstavke

Anr.370/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjore Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Hasan Aliut nga Vitia, paraqitur kundër komisionereve të vendvotimit 0437d/02d dhe 0437d/01d, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet e pasafatshme ankesa e identifikuar me numër A.nr.370/2019 datë 08.10.2019, e parashtruar nga Hasan Aliut nga Komuna e Vitisë, paraqitur kundër komisionereve të vendvotimit 0437d/02d dhe 0437d/01d.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 10.10.2019, ka pranuar një ankesë nëpërmjet postes të dorëzuar me datën 08.10.2019 nga Hasan Aliu nga Vitia, në të cilën pretendon se me datën 06.10.2019 në fshatin Llashtice janë bërë shkelje në numërimin e votave të kandidatëve në votën e tij të subjektit politik LDK dhe të numrit 42 Hasan Aliu.. Paraqitësi i ankesës pretendon se shkeljet janë bërë në vendvotimet 0437d/02d dhe vendvotimin 0437d/01d në fshatin Llashtic komuna e Gjilanit.

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme

Paneli pas shqyrtimit paraprak të ankesës, ka gjetur se nga përmbajtja e ankesës rezulton se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga ankuesi ndërlidhen me procesin e votimit, dhe se e njëjta është paraqitur pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 119 paragrafi 1 i LZP-së ku përcaktohet se ” *Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqesë ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit*”si dhe neni 5 paragrafi 3 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Rregullën Nr. 02/2015, ku përcaktohet: “*Ankesat në*

lidhje me procesin zgjedhor për ditën e votimit parashtrihen pranë PZAP-it, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit”.

Nga kjo rezulton se ankesa është paraqitur pasi që ka kaluar afati ligjor për të parashtruar ankesë, kjo nga fakti se ankesa është paraqitur në postë me datën 08.10.2019, e që ne baze te nenit 5.2 te Rregullës dhe Procedurave te PZAP-it Nr. 02/2015, konsiderohet si ditë e pranimit në PZAP-i, ndërsa shkelja e pretenduar supozohet se ka ndodhur me datë 06.10.2019, ndërsa pala ka pasur të drejtë qe ankesën në fjale ta paraqes deri me datën 07.10.2019, andaj nga kjo shihet se ankuesi ka paraqitur ankesë në PZAP pas kalimit të afatit ligjor.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart në kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së, dhe nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A.nr. 370/2019 me datë 10.10.2019

Kryesues i Panelit

Adnan Konushevc



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi lejohet e drejta në ankesë, ankesa dërgohet në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.